



BASHKIA POGRADEÇ do të hartojë **MASTER PLANIN URBAN-MJEDISOR**

Mes Planit Urbanistik mbështesim riaktivizimin e **Sektorit të Ndërtimit**

Konsiderojmë **Sektorin e Ndërtimit** dhe **Sipërmarrjet** që operojnë në këtë Sektor, si të rëndësisë së veçantë në ekonominë e Pogradecit dhe si sektor vendimtar të ndërhyrjes së individit në territor.

Projekti Strategjik i Zhvillimit të Integruar **“mat”**, për Bashkinë e Pogradecit, bazuar mbi prioritetin e hartimit të **Master Planit Urban-Mjedisor**, do të ketë konsulent dhe partner të parë, Sipërmarrjet (kompanitë) e Sektorit të Ndërtimit, duke u dhënë mundësinë të frymëmarrin, pas një kohe të gjatë staniacioni dhe bllokimi të aktivitetit të tyre privat.

Bashkia do të jetë mbështetësi kryesor që këto kompani të fillojnë sërish aktivitetin e tyre, duke ditur se riaktivizimi i këtij sektori, ndikon në mënyrë direkte, në hapjen e vendeve të reja të punës.

Sipërmarrjet në Sektorin e Ndërtimit janë njëkohësisht Investitorët potencialë, të cilët do të vënë në funksion Partneritetin Publik-Privat, si filozofia e administrimit të Bashkisë nën drejtimin e Alternativës sonë (2015-2019).

BASHKË PËR POGRADECIN

Eduart Kapri